



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Kamëz, më 17.09.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështin “Dom Nikoll Kaçorri”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39390000-1:
Mobilime te ndryshme**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,830,437(katër milion e tetëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë)lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamez** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për këtë procedurë prokurimi, bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me urdhër nr.9384 datë 14.10.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivin për tenderin.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari

përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 9 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 5, pika c në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB – së për vitin 2024 (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar në QKB).

Argumentimi:

*Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”¹ (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;...** 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e*

nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. **Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

3. **Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi **nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, dhe 2024 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në

bashkim, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (indryshuar), vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën** sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 4** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. **Për të provuar përvojën e mëparshme**, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në **çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.”

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoi kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

2.3.2.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombetare dhe të paraqese:

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme);
- b) **ISO 14001:2015** ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit” (e vlefshme);
- c) **ISO 45001:2018/ ISO 45001-2023** (të përditësuar)ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme);

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a dhe 2** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me

karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së mallit/ produktit objekt prokurimi në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së mallrave/artikujve që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatën e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këtë mall (ka të bëjë me parimet e produkteve, duke filluar nga faza e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produktit/ materialit) duke i dhënë besimin e plotësimit të kërkesave të cilësisë për mallin/ produktin blerësit (Autoritetit Kontraktor).

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 ose 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart, duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e marrëveshjes kuadër. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë, besueshmërisë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues kur është i **profilit prodhues duhet të ketë të punësuar minimalisht 15 punonjës, kur është i profilit tregëtues (kur është tregëtues i mbi 50 % të numenklatures së artikujve të kërkuar) jo më pak se 10 punonjës** të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të **paktën 2 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.**

Nga keto:

- 1(nje) inxhinier druri (shoqerite prodhuese) vërtetuar me:
- kontratën individuale të punës;
diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.
- 4 (kater) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me (shoqerite prodhuese dhe tregëtuese):

- kontratën individuale të punës;
diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit në profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- 2 (dy) shofer (shoqëritë prodhuese dhe tregëtuese) vërtetuar me:
 - kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
 - leje drejtimi, e vlefshme;
- 8 punonjës të thjeshtë (shoqëritë prodhuese dhe tregëtuese) për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:
 - kontratën individuale të punës;

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës. Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare **dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.** Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, **kapacitetet teknike dhe profesionale,** autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej 2 (dy) shofer, **2 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave**, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 40 pika 5/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e personelit që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” dhe afatit të ekzekutimit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, dhe ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat vërtetojnë **aftësinë e stafit që do të angazhohet për kryerjen e shërbimit (Leje drejtimi dhe Çertifikatën e aftësisë profesionale)** dhe **disponimin/punësimin e tyre (listëpagesa)**, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën **2 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave**, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në personelin që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në **2 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave**, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

2.3.4.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë,

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti me kapacitet mbajtes min 1.5	2 copë	Pronësi ose me qera

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave.

Shenim: Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (**Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës, **i cili do të shërbejë për transportin e mallrave objekt prokurimi**, ku kapaciteti mbajtës i tij është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e kontratës objekt prokurimi dhe se për vërtetimin e disponimit të tij duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë, dhe të marrjes me huapërdorje ose me qira të mjetit, si dhe dokumentacionin sipas legjislacionin në fuqi për lejin e qarkullimit të mjeteve. Njësia vendosi të kërkoj kushtin e mësipërm sepse ai ka lidhje të ngushtë me objektin e kontratës dhe është në përpjesëtim me objektin e kontratës. **Njësia vlerëson se pa këtë mjet transporti një operator ekonomik nuk mund të realizoj furnizimin e mallrave të parashikuar në këtë prokurim.**

2.3.5.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt e listës së kërkuar. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt e listës së kërkuar Ky kriter është i nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses

2.3.6.. Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin persiper për furnizim, për artikujt e kërkuar si më poshtë duhet të paraqesë dokumentacion të akredituar si **“Certifikate/Certifikate Testimi/Raport testimi”** për produktet:

Karrige statike pa krahe mbeshtetes (Karrige), produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 (SSH EN 1335-1:2021) Mobilje zyre - Karrige pune për zyra - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njevlefshme dhe e perditësuar, SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje për zyra - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë) ose e njevlefshme dhe e perditësuar

- **Tavoline pune (tavoline pune/zyre)**, produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat, ose e njevlefshme dhe e perditësuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 Mobilje për zyra - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë ose e njevlefshme dhe e perditësuar

- **Sirtariere (Komedine/Sirtariere)**, produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 15338:2007 + A1:2010 (15338:2024) Aksesorë metalik për mobilje – Rezistenca dhe qëndrueshmëria e mekanizmave zgjatues (shinat) dhe komponentëve të tyre, ose e njevlefshme dhe e perditësuar

- **Karrige klase** produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, EN 1729-2023 Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e proves ose e njevlefshme dhe e perditësuar

- **Karrige kopshti** produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, EN 1729-2023 Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e proves ose e njevlefshme dhe e perditësuar

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara për zbatimin në cilësi të kontratës për këtë object sipas standarteve te kerkuara ne specifikimet teknike. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithë artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Me qëllim garantimin e përmbushjes së kontratës objekt prokurimi, njësia e prokurimit e vlerëson të domosdoshëm faktin që, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet detyrimisht të deklarojnë se marrin përsipër kryerjen e shërbimit të transportit të mallrave, montimit dhe vendosjes së tyre në adresat që do të përcaktohen në planin e shpërndarjes të autoritetit kontraktor, kjo me qëllim për të përjashtuar mundësinë që kontraktuesi të pretendojë se një shërbim i tillë nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit për këtë prokurim, ku A.K. do t’i duhet që të paguajë kosto shtesë për transportin, montimin dhe vendosjen e tyre.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 (nje) vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit

Argumentimi: Njësia e prokurimit referuar specifikës që kanë disa prej mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **një deklaratë garancie që garanton mbulimin e garancisë së mallrave/pajisjeve elektrike/ elektromekanike objekt prokurimi për një periudhë jo më pak se 1 (nje) vjecare**, duke filluar nga data e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor, pasi mund të gjendemi përpara rastit ku këto pajisje mund të jenë të një cilësie të dobët, të kenë defekte fabrikimi etj., ku O.E. duhet të jetë i gatshëm për zëvendësimin e tyre, gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë se marrin përsipër të kryejnë furnizime të pajisjeve cilësore të kërkuar.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

2.3.10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë miratimi, me anë të së cilës deklaron se artikujt për të cilët është kërkuar në specifikime teknike plotësimi i standardeve të vecanta i plotësojnë ato dhe merr përsipër dorëzimin e tyre para lidhjes së kontratës nëse shpallet fitues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme **2.3.9, 2.3.10**, janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kriteret në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen ,mund të përcaktojë kriteret e vecanta në varësi të objektit që prokurohet ,të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.11.Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra (një copë) sipas specifikimeve teknike të dhënë në DST të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë AK, si më poshtë: tavolinat e nxënësve, tavolinat e mesuesëve, karrige nxënës, karrige për mësues, tabelë e zezë (sipas përcaktimeve në preventive).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është kërkuar bazuar në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 162. datë 23.11.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", neneve 2, në pikën 6 të Nenit 40 dhe 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (në vijim "VKM"), i ndryshuar VENDIM Nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave", sipas së cilës: *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, Mostrat trajtohen si informacion konfidencial dhe janë në kontroll të autoritetit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit*".

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.

Mostrat e paraqitura do të kontrollohen nëse përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, për të dhënë garanci operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të procedurës objekt prokurimi,

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala "**kërkoni**" nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë teknike, profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë, si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.7186, datë 20.08.2025 "Kërkesë për Blerje pajisje mobilje për shkollën 9 vjeçare dhe kopështin "Dom Nikoll Kaçorri"** dërguar nga Drejtoria e Arsimit Rinise dhe Sporteve / Bashkia Kamez, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt

prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹” (i ndryshuar), dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e D.T. ngarkuar ne S.P.E. e A.P.P., për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të L.P.P. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 29.09.2025, ora 09.⁰⁰**
vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al Bashkia Kamëz .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

